



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 27.02.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me numër të referencës: MAAEBL-0284/B, lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit për z. Ilir Peci, ish Kryetar i Komunës së Zveçanit, përkitazi me konkursin publik me numër të referencës RN00018500, të datës 25.08.2025, të shpallur nga Komuna e Zveçanit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi lidhur me konkursin publik RN00018500, të datës 25.08.2025, të shpallur nga Komuna e Zveçanit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit, pasi që siç theksohet në kërkesë (citojmë): “[...] *Ne konkursin e hapur nga KK Zveçan me numër të referencës RN00018500 disa java me parë Kryetari po ashtu punëson edhe mbesën tjetër në Drejtorin për Menaxhimin e Katastrofave Natyrore A.P., edhe për këtë pozitë janë ofruar pyetjet paraprakisht nga D.I.ZH. [...]*”.

Agjenci për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetim administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit, duke u bazuar ne dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, Agjencia përmes shkresës zyrtare (DPKI-3282/25) ka kërkuar dhe siguruar informacion/dokumentacion nga Komuna e Zveçanit, dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të informacionit/dokumentacionit në dispozicion, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Drejtoria për Menaxhimin e Katastrofave Natyrore përmes kërkesës së datës 21.08.2025, me nr. 46/25, ka kërkuar nga Kryetari i Komunës së Zveçanit që të aprovohen pozitat për shpalljen e konkurseve për pozitat: Zyrtar për emergjenca dhe Asistent administrativ në kuadër të Drejtorisë për Menaxhimin e Katastrofave Natyrore;

Më datë 25.08.2025, Komuna e Zveçanit ka publikuar konkursin me titull: Asistent Administrativ në Drejtorinë e Menaxhimit të Emergjencave, administrimin e ujërave dhe mbrojtjen e mjedisit, me numër të Referencës RN00018500;

Me vendimin Nr. 1412/25, të datës 01.04.2025, Kryetari i Komunës së Zveçanit ka themeluar komisionin për pranimin dhe zhvillimin e procedurave rekrutuese dhe vlerësimin e kandidatëve për pozitat e lira të kategorisë profesionale për çdo grup të përgjithshëm apo të veçantë me mandat dy vjeçar, në përbërje M.K.,A.K,M.B,L.K.P dhe B.P.;

Më datë 29.09.2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Zveçanit ka publikuar Njoftimin për Verifikim Paraprak, përmes të cilit janë bërë publik emrat e kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta në konkursin për pranim: Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita: Asistent Administrativ me numër RN 00018500, të shpallur me datë 26.08.2025;

Me datë 15.10.2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Zveçanit ka publikuar Njoftimin për rezultatet përfundimtare, për pozitën: Asistent Administrativ. *Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, duke u bazuar në Ligjin për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197, neni 39, paragrafi 11 dhe Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbim civil, neni 10 dhe 11, ju njofton se pas vlerësimit përfundimtar të Komisionit të pranimin, kandidati fitues për këtë pozitë është: A.P;*

Lidhur me pretendimin e raportuesit të rastit se: *“Ne konkursin e hapur nga KK Zveçan me numër të referencës RN00018500 disa java me parë, Kryetari po ashtu punëson edhe mbesën tjetër në Drejtorin për Menaxhimin e Katastrofave Natyrore A.P”*, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar informacion/dokumentacion nga Komuna e Zveçanit nëse gjatë procesit të rekrutimit është lajmëruar (njoftuar me shkrim) nga ana e zyrtarëve vendimmarrës ndonjë rast i tentim apo ushtrim të ndikimit në këtë proces të rekrutimit. Sipas informacioneve të pranuar rezultojnë se kabineti nuk posedon asnjë informacion qoftë me shkrim apo gojarisht, si dhe asnjë dokument që lidhet me ndonjë ankesë apo ushtrim ndikim në procesin e rekrutimit në fjalë.

Pas trajtimit të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion, si dhe bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konstaton si në vijim:

Fillimisht, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”.

Lidhur me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

“Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”, si dhe me nën-paragrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

“person i afërm me zyrtarin është - bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin.

Pastaj, nënparagrafi 1.12 i këtij neni, e definojnë nocionin vendimmarrje si:

“Çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”

Situata e konfliktit të interesit është i lidhur ngushtë me vendimmarrjen dhe/apo çastet paraprake të vendimmarrjes lidhur me ekzistencën e interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm në një çështje të caktuar, e që lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit, nuk është gjetur ndonjë element përmbajtjesor që në kuptim të dispozitave të sipërcituara të jenë plotësuar kushtet kumulative, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo personave të afërm me të.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, bazuar në dokumentacionin në dispozicion konstaton se në kuptim të dispozitave të sipërcituara, z. Ilir Peci, ish Kryetar i Komunës së Zveçanit nuk ka qenë pjesë e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit, lidhur me punësimin e mbesës së tije në pozitën asistent administrativ, prandaj në rastet kur mungon vendimmarrja në një çështje konkrete nga zyrtari (si kusht i domosdoshëm kumulativ), përjashtohet situata e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, edhe nëse ekziston afërsia familjare, përkatësisht plotësohet njëri nga elementet thelbësore siç është interesi privat i personit të afërm, por mungon vendimmarrja e zyrtarit si kusht tjetër kumulativ, përjashtohet konflikti i interesit.

Po ashtu, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, nuk ka gjetur se ka pasur ndonjë deklaratë me shkrim nga anëtarët e komisionit për tentim në ndikim në vullnetin e tyre, në kuptim të nenit 16 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

“Nëse ekziston tentimi i ndikimit në vullnetin e tij, zyrtari duhet ta lajmërojë me shkrim dhe të konsultohet me udhëheqësin apo institucionin udhëheqës të organit që e ka zgjedhur apo emëruar në mënyrë që të shmang çdo ndikim në vullnetin e tij.”

Ndërsa, sa i përket pretendimit tjetër të raportuesit të rastit lidhur me atë se edhe për këtë pozitë janë ofruar pyetjet paraprakisht nga D.I.ZH, nga shqyrtimi i shkresave në lëndës, rezulton se znj. D.I.ZH. nuk ka qenë e emëruar si anëtare e komisionit për vlerësimin e kandidatëve në procedurën rekrutuese për pozitën asistent administrativ dhe rrjedhimisht nuk rezulton që e njëjta të ketë qenë pjesë e procesit të rekrutimit në fjalë.

Po ashtu, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit këtë rast e ka trajtuar vetëm në kontekst të konfliktit të interesit, dhe nuk ka trajtuar çështje tjera të cilat janë jashtë sferës së konfliktit të interesit.

Prandaj, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit lidhur me rastin e raportuar.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

